



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1810 Prot.

Tiranë, më 27.12.2019

V E N D I M
Nr. 218 dt. 27.12.2019

“Mbi paralajmërimin e institucionit Bashkia Durrës, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të hetimit administrativ mbi gjendjen e marrëdhënieve në shërbimin civil, të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë,

VËREJ SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të nenit 65, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dispozitë e cila urdhëron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për ata nëpunës të cilët kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, si dhe të detyrave të lëna në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2018”, ku shprehimisht është kërkuar: “Të shqyrtohen me prioritet rastet e individëve, pjesë e shërbimit civil në administratën qendrore dhe vendore, të cilët vazhdojnë marrëdhëniet e punës, megjithëse kanë arritur moshën e pensionit dhe duhet të kishin ndërprerë në kohë marrëdhëniet juridike dhe financiare”, ka realizuar procesin e verifikimit lidhur me zbatimin e ligjit në këtë rast, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

Për të kryer këtë detyrë, ndërmjet të tjerave, është kërkuar nga njësitë përgjegjëse në institucionet e përfshira në këtë proces, që të raportojnë në lidhje me ata nëpunës, të cilët megjithëse kanë plotësuar moshën e pensionit të pleqërisë, ende vazhdojnë marrëdhënien e punës në pozicione të shërbimit civil.

Në këtë proces është përfshirë edhe institucioni i Bashkisë Durrës si institucion i cili punëson nëpunës civil. Pas kërkesës së Komisionerit për informacion, nëpërmjet shkresës nr.

12738/1 prot., datë 13.07.2019, institucioni ka raportuar në lidhje me punonjësit që plotësojnë moshën e pensionit të plotë të pleqërisë deri në fund të vitit kalendarik.

Në këtë institucion punonjësit që plotësojnë këtë kusht, të evidentuar sipas pozicionit të punës dhe momentit të plotësimit të moshës për të përfunduar pensionin e plotë të pleqërisë janë:

- ***** “*Inspektor*”, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 28.08.2019;
- ***** “*Specialiste*”, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 23.11.2019;
- ***** “*Specialist*”, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 17.11.2019.

Në lidhje me këtë aspekt të administrimit të shërbimit civil, në përmbajtjen e nenit 65, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, evidentohen në mënyrë të shprehur rastet e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ligjit, si edhe afati dhe organi që konstaton rrethanat, si më poshtë:

“1. Marrëdhënia në shërbimin civil përfundon për shkak të ligjit kur:

- a) nëpunësi vdes apo kur merr formë të prerë vendimi për deklarimin e vdekjes së tij;*
- b) nëpunësi humbet shtetësinë shqiptare apo merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar;*
- c) plotësohet moshja për pensionin e plotë të pleqërisë;*
- ç) konstatohet pavlefshmëria e aktit të emërimit;*
- d) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.*

2. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të ligjit, konstatohet 5 ditë nga ndodhja apo njohja e tij nga:

- a) njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ku nëpunësi ushtron detyrën;*
- b) DAP-i për anëtarët e TND-së.”*

Në këto kushte, plotësimi i moshës për pensionin e plotë të pleqërisë, në rrethanat e çështjes që po shqyrtohet, është një prej rasteve që parashikohet në pikën 1/c, të kësaj dispozite dhe për këtë arsye, njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ku nëpunësit ushtrojnë aktualisht detyrën, sipas pikës 2/a, të nenit të cituar më sipër, duhet të veprojnë menjëherë duke e konstatuar këtë fakt, në një afat që në ligj është parashikuar 5 ditë nga ndodhja apo njohja e tij, si dhe duke i njoftuar ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, nëpunësve civilë: ***** , ***** dhe *****.

Pozicionet e punës të cilat do të mbeten të lira pas këtij veprimi, duhet të shpallen vakante, për tu plotësuar, sipas procedurës dhe kërkesave të neneve 21, 22, 23 etj., të ligjit në fjalë.

Për të gjitha sa analizuam më sipër, bazuar në nenin 15, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar dhe pikës 9, të nenit 16 të rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015,

V E N D O S A:

1. Të kërkoj nga Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Durrës marrjen e masave të menjëhershme për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, duke përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil për shkak të ligjit, për punonjësit e mëposhtëm:
 - ***** “*Inspektor*”;
 - ***** “*Specialiste*”;
 - ***** “*Specialist*”.
2. Pozicionet respektive të punës, të shpallen menjëherë pozicione të lira dhe të fillojnë procedurat për plotësimin e tyre sipas kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil.
3. Kryerja e veprimeve të mësipërme, duhet të bëhet brenda **7** ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim.
4. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, si dhe të dërgojë aktet administrative të cilat vërtetojnë realizimin e detyrave.
5. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve, që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjorbitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
6. Të njoftohet për këtë vendim Kryetari i Bashkisë Durrës dhe Njësia Përgjegjëse. Njësia Përgjegjëse, të njoftojë punonjësit për të cilët është urdhëruar përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për vendimin e Komisionerit..

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha